

Pershkrimi i projektit

Hidrocentrali OSMANI, parashikohet të ndërtohet në Shqipërinë e Veriut në perëndim të fshatit Krastë. Qëllimi i ndërtimit të tij është prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar ujërat e përroit Zalli i Liçonës dhe përroit të Përpizës ndërmjet kuotave 676 m dhe 437 m me anë të dy veprave të marrjes (VM) perkatesisht ne prroin e Licones (VM-1) dhe ne Prroin e Perpizes (VM-2) dhe një derivacioni me gjatësi rreth 5.4 kilometër i cili trasohet fillimisht ne bregun e djathte te Licones per rreth 600m dhe me tej kalon ne bregun e majte nepermjet nje dukeri. Rreth 292 m te ketij derivacioni eshte pjesa qe i takon perroit te Perpizes. Sa me sipër, uji ne perroin e Licones merret rreth 1 km mbi piken e takimit me përroin e Përpizës pranë ish kanalit të mullirit (Kuota 674 m). Uji ne perroin e Perpizez merret ne afersi te kaskades natyrale te poshtme te ketij perroi. Ndërtesa e centralit parashikohet të ndërtohet rreth 550 m mbi derdhjen e përroit Zalli i Liçonës, në krahun e djathtë të Lumit Mat. Treguesit kryesor të Hidrocentralit OSMANI janë:

HIDROCENTRALI

- Tipi	Me Derivacion.
- Rënja bruto.....	239 m
- Fuqia teorike ndërmjet kuotave 676-437 m	2.5 Mw
- Energjia mesatare vjetore Teorike, Et	21.8 Gwh
- Prurja llogaritëse	1.07 m ³ /s
- Fuqia e Instaluar	2.0 Mw
- Energjia mesatare vjetore, E	7.34 Gwh
- Koeficienti i prodhimit mesatar Vjetor E / Et ...	33.67 %
- Energjia e prodhuar në vitin e Thatë	6.8 Gwh
- Energjia e prodhuar në vitin e Lagët	8.0 Gwh
- Orë pune në vitin Mesatar	3669 Orë
- Orë pune në vitin Thatë	3381 Orë
- Orë pune në vitin e Lagët	3996 Orë
- Turbina të tipit Pelton me aks horizontal.....	2 copë
- Fuqia e Turbinës.....	1.0 Mw
- Tubacioni turbinave me diametër D=600/10 mm	1 copë
- Gjatesia e Tubacionit te turbinave	347 ml

DIGA NIVELNGRITËSE DHE SHKARKUESI NE PRROIN E LICONES

- Është e tipit me beton me galeri gjatësore të mbuluar me zgarë (Tiroleze).	
- Gjatësia e kurorës së digës.....	18.0 m
- Kuota e kreut të digës.....	679.0 m
- Kuota e pragut kapërderdhës	676.0 m
- Kuota e pragut të galerisë	675.92 m
- Niveli maksimal në anën e sipërme per Q5%.....	678.49m
- Niveli maksimal në anën e sipërme per Q1%.....	678.87m
- Gjatësia e zgarës.....	12 m

DIGA NIVELNGRITËSE DHE SHKARKUESI NE PRROIN E PERPIZES

- Është e tipit me beton me galeri gjatësore të mbuluar me zgarë (Tiroleze).	
- Gjatësia e kurorës së digës.....	8.0 m
- Kuota e kreut të digës.....	678.5 m
- Kuota e pragut kapërderdhës	676.0 m
- Kuota e pragut të galerisë	675.92 m
- Niveli maksimal në anën e sipërme per Q5%.....	677.79m
- Niveli maksimal në anën e sipërme per Q1%.....	678.07m
- Gjatësia e zgarës.....	5 m

DERIVACIONI DHE DEKANTUESIT

- Gjatësia totale	3.167 km
- Gjatësia e Tunelit në formë patkoi	0.43 km
- Seksioni tërthor i kanalit	0.8 x 1.1 m
- Seksioni tërthor i tunelit (përfshirë rrugën).....	3.5 x 4.5 m
- Dekantuesi 1 me nje dhome me gjatesi	32 m
- Dekantuesi 2 me nje dhome me gjatesi	13 m

VEPRA E MARRJES - 1 NË PËRROIN E LICONËS

Vepra e Marrjes (VM - 1) në përroin Zalli i Liconës është e tipit malore me dige nivel ngritese me zgarë e cila do të shërbejë edhe si shkarkues i ujërave të tepërta gjatë periudhës ujëshumë. Bazuar në kushtet topografike e gjelogo-inxhinierike, është pranuar si më i favorshëm aksi i veprës VM 1 rreth 100 m nën urën këmbësore. Kuota e pragut kapërderdhës është pranuar 676 m. Shtrati i lumit në këtë aks është 674m. Foto 9.1 dhe figura 9.1 paraqesin pozicionin e përzgjedhur për ndërtimin e veprës së marrjes dhe një prerje gjatësore e veprës së marrjes.


Vepra e marrjes si objekt i kompozuar në këtë formë përbëhet nga: Shkarkuesi i Ujrave të tepërta, Zgara ujëmarrëse dhe zhavorrkapësi. Më poshtë jepen detaje të këtyre nënobjekteve dhe llogaritjet hidraulike të bëra për kushtet specifike të kësaj vepre marrjeje.



Zona ku do të ndërtohet Vepra e Marrjes së HC OSMANI, në përroin Zalli i Liçonës

karakteristike dhe një vlerë prej 157m³/s që i takon rastit ekstrem kur niveli i ujit arrin deri 10cm nën kreun e digës.

HIDROCENTRALI "OSMANI"
Shkarkuesi I plotave
Kurba Q=F(H) per kapërderdhesin



H	0.00	0.10	0.20	0.50	0.75	1.00	1.50	2.00	2.50	3.00	3.50
Q	0	0.7	1.9	9.3	18	29	55	86	121	160	203

Figura 9.2 Kurba e aftësisë shkarkuese të kapërderdhësit në veprën e marrjes 1.

Shtresa zhavorore në këtë zonë është rreth 2 m. Vepra parashikohet të inkastrohet në formacionin bazë në një thellësi minimum 1.0m. Pjerrësia natyrale e shtratit është 5%. Nga pikpamja e formacionit gjeologo-inxhinierik, Vepra e Marrjes mbështetet mbi formacione shkëmbore kompakte. Për këtë arsye në këtë fazë të studimit, nuk është planifikuar asnjë masë kundërfiltrimi, kjo do të saktësohet në fazat e mëtejshme të projektimit. Sidoqoftë konturi nentokesor i saj kështu sic parashikohet garanton mos filtrimin dhe sufozine.

ujrat e tepërt në pusin e shkarkuesit. Po ashtu në fund të zhavorrpësit (fillim të kanalit të derivacionit) planifikohet të ndërtohet një diafragmë betoni e cila nuk do të lejojë të kalojë ndonjë

prurje e pakontrolluar në kanal të derivacionit. Para diafragmës vendoset një portë 1x1.1m për hapjen dhe mbylljen e rrjedhjes nga zhavorrpësi në kanal të derivacionit.

VEPRA E MARRJES - 2 NË PËRROIN E PËRPIZËS

Në foton 9.2 tregohet pozicioni ku është parashikuar të ndërtohet Vepra e Marrjes (VM - 2) në përroin e Përpizës.




Foto 9.2 Zona ku do të ndërtohet Vepra e Marrjes VM– 2, në përroin e Përpizës

Vepra e Marrjes (VM - 2) në përroin e Përpizës është e tipit malore me zgarë të vendosur mbi një digë kapërderdhëse e cila do të shërbejë edhe si shkarkues i ujërave të tepërta gjatë periudhës ujëshumë. Kuota e pragut kapërderdhës është pranuar 676 m. Shtrati i lumit në këtë aks është në kuoten 674.5m. Foto 9.2 paraqet pozicionin e përzgjedhur për ndërtimin e veprës së marrjes. Figura 9.2 jep planimetrinë dhe prerjen gjatësore të veprës së marrjes.

Vepra e marrjes si objekt i kompozuar në këtë formë përbëhet nga: Shkarkuesi i Ujrave të tepërta, Zgara ujëmarresë dhe zhavorrkapësi. Më poshtë jepen detaje të këtyre nënobjekteve dhe llogaritjet hidraulike të bëra për kushtet specifike të kësaj vepre marrjeje.




Figura 9.3 Planimetria dhe Prerja Gjatësore e Veprës së Marrjes VM – 2, në përroin e Përpizës

Shkarkuesi i Ujrave të tepërta

Bazuar në kushtet teknike të projektimit, për një hidrocentral me fuqi deri në 2 MW dhe një digë të tillë me lartësi 3m, prurjet maksimale llogaritëse dhe kontrolluese janë ato me përsëritje përkatësisht një herë në 20 vjet (5%) dhe një herë në 100 vjet (1%). Nga studimi hidrologjik rezultojnë se këto prurje janë: $Q_{\text{max llog}} = Q_{5\%} = 32 \text{ m}^3/\text{s}$, dhe, $Q_{\text{max kon}} = Q_{1\%} = 40 \text{ m}^3/\text{s}$.

Lartësia e ujit në lumë në seksionin ko do të vendoset tubi sipas llogaritjeve rezulton të jetë $h=4.57\text{m}$ për prurjen llogaritëse $Q_{\text{llog5\%}} = 120 \text{ m}^3/\text{s}$ dhe $h=5.15\text{m}$ për prurjen kontrolluese $Q_{\text{kontr1\%}} = 150 \text{ m}^3/\text{s}$.

Në mënyrë që të mbrohet tubacioni nga rrjedhja e ujit gjate plotave, tubi do të vendoset në një lartësi prej 6.0m nga shtrati i lumit, pra në kuotën 626.00m .

Figura 9.5 Planimetria ku paraqiten Dekantuesi-1, Dekantuesi-2 dhe Dukeri

Figura 9.6 Prerje gjatësore e Dukerit

DERIVACIONI

Sic u theksua edhe më sipër, derivacioni ka një gjatësi totale prej rreth $3\ 167 \text{ m}$. Ai përbëhet nga gjashtë pjesë.

- **Pjesa e parë**, një kanal pa presion me gjatësi 572 m , nga vepra e marrjes 1 deri në hyrje të dukerit me pjerrësi $2/1000$ dhe përmasa $b \times h = 1 \times 1.1\text{m}$. Kjo pjesë e derivacionit trasohet në shpatin e djathtë të përroit të Liconës;
- **Pjesa e dytë**, një kanal pa presion me gjatësi 292m , nga vepra e marrjes 2 deri në hyrje të dukerit me pjerrësi $3.5/1000$ dhe përmasa $b \times h = 0.6 \times 0.7\text{m}$. Kjo pjesë e derivacionit trasohet në shpatin e majtë të përroit të Përpizës dhe më tej ai kalon qafën dhe është trasuar në shpatin e djathtë të Liçonës në drejtim të kundërt të rrjedhjes.
- **Pjesa e tretë**, është një Duker me një gjatësi 233m i cili ndërtohet me tubacion celiku me diametër $850/6.3\text{mm}$. Ky objekt intersekon përroit e Liconës nga bregu i djathtë në të majtën.
- **Pjesa e katërt**, kanal me gjatësi $1\ 160 \text{ m}$, me përmasa $b \times h = 1 \times 1.1\text{m}$ dhe pjerrësi $2/1000$.
- **Pjesa e pestë**, me gjatësi 430 m , në formën e një tuneli pa presion me përmasa $b \times H = 3.5 \times 4.5 \text{ m}$. Në mes të bazës së tunelit do të hapet një kanal me përmasa $b \times h = 0.8 \times 1.1\text{m}$, dhe pjerrësi të njëllajtë me tunelin $4/1000$.
- **Pjesa e Gjashtë**, kanal me gjatësi 480 m , me përmasa $b \times h = 1.0 \times 1.1\text{m}$ dhe pjerrësi $2/1000$.

Theksojmë se në fazat e mëtejshme të projektimit do të përcaktohen më saktë gjatësitë e secilës pjesë të derivacionit. Në faqen në vijim (Figura 9.6) jepet një prerje gjatësore e derivacionit dhe seksionet tip që parashikohen të përdoren për realizimin e tij.

Kanali i derivacionit do të kalojë me kuotë të kërkuar përgjatë shpatit të majtë të shtratit të përroit. Në këtë fazë të studimit është pranuar që seksioni i kanalit të jetë drejtkëndësh dhe i mbuluar.

Paralel me kanalën është planifikuar të ketë një rrugë shërbimi me gjerësi minimale 3.5 m . i njëjti kriter është përdorur edhe për rastin e zonës me tunel. Seksioni i kanalit është planifikuar të ndërtohet në gërmim (Tipi 1, Tipi 2).

Pjerrësia e kanalit ka rezultuar 2.0 për mijë. Përmasat e seksionit tërthor të kanalit do të jenë $b \times H = 1.0 \times 1.1$ m. Franko e kanalit është pranuar 0.3 m.

Nga pikpamja gjeologo-inxhinierike kanali kalon në trase të sigurtë e të qëndrueshme.

Kanali do të përshkojë disa thellime erozionale të relievit që do të trajtohen me tombino ose mbikalime të rrjedhjes ujore apo asaj të ngurtë.

Përgjatë rrugës kanali intersekon disa procka.

Traseja fillimisht do të hapet si trase rruge e cila do të shërbejë për ndërtimin e seksionit të kanalit.

Në këtë fazë të studimit seksioni i kanalit është llogaritur për **prurje 1.1 m³/s (duhet ndryshuar 1.3 m³/s)** me thellësi e gjerësi konstante në të gjithë gjatësinë e tij, por në fazat e mëtejshme të

projektimit kanali do të studjohet edhe më në detaje. Kjo do të kërkojë një analizë më të hollësishme tekniko-ekonomike si dhe të dhëna më të shumta hidrologjike, etjere.

Pjesa me gjatësi rreth 430 m, është konceptuar me tunel. Seksioni i tunelit do të jetë tip Patkua me përmasa $b \times H = 3.5 \times 4.5$ m. Kanali në tunel parashikohet po ashtu të punojë pa presion dhe ndërtohet në mes të seksionit të tunelit. Paraprakisht nuk është parashikuar veshja e tavanit të tunelit, por në fazat e mëtejshme sipas kushteve gjeologo inxhinierike mund të përdoret një shtresë torkret e armuar, më tepër si masë mbrojtëse për mosrënien e gurëve në seksionin e rrjedhjes së ujit.

Dherat që do të dalin nga gërmimet e trasesë së kanalit dhe rrugës, pjeserisht do të sistemohen në skarpatën e djathtë duke i veshur ato me shtresa vegjetale në përshtatje me mjedisin përreth. Pjesa tjeter do të depozitohet në vende që do të caktohen nga pushteti lokal. Po ashtu për gjatë kanalit parashikohet të mbillen drurë të ndryshëm të cilët do të krijojnë një ansambël të përshtatshëm me pyjet përreth.



Duke patur synimin që të arrihet një shfrytëzim sa më i plotë i rrjedhjes ujore është pranuar që të montohen dy turbina me prurje 0.55 m³/s secila. Edhe për këtë rast tipi i turbinës rezulton të jetë PELTON me aks Horizontal.

Detaje të turbinave do të jepen pasi të jetë përzgjedhur prodhuesi i tyre.

CENTRALIT

Pozicioni i ndërtesës është zgjedhur në anën e djathtë të shtratit të lumit Mat duke parashikuar që një pjesë e saj të futet në skarpatën e shpatit. Kuota e dyshemesë së ndërtesës do të varet nga parametrat hidraulike të veprës së marrjes së Kanalit të Derivacionit të hydrocentralit të Stavecit në të cilin do të derdhen ujërat e HC OSMANI.




Foto 9.3 Vendi ku do të ndërtohet ndërtesa e Centralit dhe tubacioni i turbinave

Në këtë fazë të studimit kuota e dyshemesë së centralit është pranuar 436 m dhe aksi i turbinës në kuotën 437m

E gjykuar nga pikpamja gjeologjike inxhinierike ndërtesa inkastrohet në shkëmb ultrabazikë relativisht të fortë. Në planimetri ajo është kompozuar me tre seksione, dy për turbinat dhe një shesh montimi.



a.Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.

Bimesia ne zonen e ndertimit te HEC

Në lidhje të ngushtë të elementit klimatik tokësor, veshja bimore paraqitet me zonalitet vertikal të dukshëm. Veshja bimore e zonës në studim përbëhet nga brezi i ahut dhe halorëve që shtrihen deri në kuotën 1600 – 1700m. Në katin e halorëve ndikimi i pyllit në rrjedhën ujore ndihet gjatë gjithë vitit. Mat. I gjithë mali është i pyllëzuar sidomos me pishë dhe ah.

Bimesia zona e Dibres

Shkurret malore[

Ky kat bimor shtrihet nga 380-600 m mbi nivelin e detit e marre ne total kjo bimesi ze 31% pra ze nje siperfaqe te vogel te gjithe bimësisë zones.Zhvillohet nen nje klime me te bute se brezat e tjere.Ne kete brez shfaqet nentipi I shitblikut perbere nga bime qe I leshojne gjethet.

Duhet theksuar se ky kat eshte mjaftë I demtuar nga dora e njeriut dhe e zevendesuar nga toka te punueshme prandaj ne shume sektore te ketij brezi shfaqet degradimi.Ky kat bimor shfrytezoher per kullota dhe dru zjarri. Duhet theksuar se ky kat ka edhe shume bime me vlera mjeksore dhe mjaltese.

Kati I Dushkut, ky kat bimor shtrihet nga 600- 1000 m, eshte I perhapur net e gjithe zonen dhe ze 17 % te bimesise totale te Malesise . LLojet kryesore te bimeve jane: Dushku, panja, lajthia, bunga, etj. Edhe ky kat eshte shume I demtuar pasi bimedia e tij shfrytezoher per ngrohje ne stinen e ftohte.Kati I Ahut dhe I haloreve: ky kat shtrihet nga 1000-1700 m mbi nivelin e detit. E gjith siperfaqja e ktij kati ze 23% te bimesise se zones. Perhapjen me te madhe e ka ne pjesen jug-lindore dhe lindore. LLoji kryesor I bimes mbizotruese eshte Ahu, nga e ka marre emrin kati.

Ne perberje te ketij kati marrin pjese edhe bredhi , pisha, qe jane me pak te pechapura, por takohen edhe panja, Frasheri, meshtegna, etj. KY kat bimor ka pasurite me te medha floristike te perbere nga pyjet te ahut dhe te pishes, kjo bimesi kushtezon edhe zhvillimin e ekonomise pynjore qe perben nje nga aktivitetet kryesore te popullsise te kesaj komune. Kullotat Alpine, ne Malesine e korabit me qe ka reliev te larte nje shtrirje te konsiderueshme ka edhe kati bimi kulotave alpine.duhet theksuar se ne kullota te kesaj komune kullosin rreth 15 krere bageti te imta dhe 1500 krere gjegje te Klima e ashper dhe me rreshje te shumte te debore ka kushtezuar zhvillimin e ketij kati bimor. Kjo lloje bimesie eshte e tipit graminace ka perhapje mbi 1700 m konkretisht ne malin e,deshatit dhe lartesi te tjera. Ky kat shfrytezoher si kullot per bagetine ne stinen e ngrohite te vitit, po ashtu krijon edhe nje peisazh te bukur piktoresk duke krijuar mundesi te shumte e te medhe per zhvillimin e turizmit te gjelbert.


**b. Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.**

Përroi Zalli i Liçonës është njëra nga degët e pjesës së sipërme të lumit Mat, ai ka një pellg ujëmbledhës në derdhje me një sipërfaqe rreth 36.5 km². Pellgu i këtij përroi shtrihet 100% në territorin e Shqipërisë. Emërtimin Përroi Zalli i Liçonës e merr pas bashkimit të përroit të Batrës me Përroin Vori i Llahingës në kuotën 1482 m mbi nivelin e detit. Në kuotën 590 m mbi nivelin e detit në shtratin e Zallit të Liçonës derdhet dhe përroi i Përpizës me një sip 4.67 km²

Burimet e ujit që furnizojnë përroin Zalli i Liçonës fillojnë rreth kuotës 1890 m mbi nivelin e detit si dhe nga Liqeni i Sopeve me kuotë 1724 m mbi nivelin e detit. Përroi i Liçonës derdhet në Lumin Mat në kuotën 410 m mbi nivelin e detit.

Morfologjia e pellgut ujëmbledhës nga burimet deri në derdhjen në lumin Mat paraqitet malore e me lugina të thella e të ngushta.

Fotot e mëposhtme paraqesin disa pamje ajrore të pellgut ujëmbledhës të përroit Zalli i Liçonës.



Pamje satelitore e pellgut ujëmbledhës të Zallit të Liçonës



c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, përfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Impaktet gjate ndertimit dhe shfrytezimit

Impakti i gjeologjise dhe gjeomorfologjise

Impakti nga ndertimi

Per kete projekt eshte planifikuar te hapet tunel ,rruge e re do te hapet rreth 2000-3000 m si dhe germime per ndertimin e infrastruktures se nevojshme per kete HEC ne teresi .Te gjitha materialet qe do te perdoren per ndertimin e veprave perkatese te HEC do te transportohen nga mjedise te tjera ku ato do te magazinohen dhe jane miqesore me mjedisin.

Impakti nga struktura fizike e projektit

Ne keto mjedise nuk do te kete depozitime gjeologjike me interes komercial pasi keto zona jane larg zonave te karrierave apo te vleresuara si potencial per zhvillim te aktiviteteve minerale.

Impakti nga operimi

Nuk do te ndikohet ne mjedisin gjeologjik gjate operimit.

Masa parandaluese

Nuk jane te kerkuara pasi do te perdoren standarte bashkohore.

Impakti ne toke

Impakti nga ndertimi

Per cdo veper ndikimi mbi toke do te jene te moderuara ,maksimumi i mundshem,por ne pergjithesi keto objekte kerkojne nje hapsire te vogel ne toke pasi kerkojne nje shtrirje ne skarpatat e rrjedhjes se perroit Zalli i Liçonës dhe përroit të Përpizës dege e lumit Mat.Nuk do te kete nevojë per shtrirjen e kabllave per transferimin e energjise pasi linja e transferimit



Por reziku ne kete rast do te jete minimal pasi do te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat teknike per cdo rast konkret. Ne lidhje me efektin e erozionit veme ne dukje se projekti nuk do te ndikojte ne terrenet ku efekti i erozionit eshte i theksuar. Objektet e vepres do te ndertohen ne vende te qendrueshme ku ky efekt eshte minimal, ndikimi i ketij procesi te ndertimit eshte i lokalizuar dhe nuk do te ndikojte ne terreneku duket qarte efekti i errozionit. Gjate germimeve per ndertimin e veprave perberese do te monitorohet ne menyre te vazhdueshme terreni i ndertimit.

Masat parandaluese

Dherat qe do te dalin nga germimet e trasese se kanalit , pjeserisht do te sistemohen ne skarpaten e majte duke i veshur ato me shtresa vegjetale ne pershtatje me mjedisin perreth. Pjesa tjeter do te depozitohet ne vende qe do te caktohen nga pushteti lokal. Po ashtu per gjate kanalit parashikohet te mbillen drure te ndryshem te cilet do te krijojne nje ansambel te pershtatshem me pyjet perreth.

Impakti ne ujrat nentokesore

Impakti nga ndertimi

Ne cdo pjese ku do te ndertohen veprat perberese te HEC –it ndikimi ne mjedisin uJOR nentokesor do te jete minimal per vete faktin se ne zonat ku do te ndertohen keto vepra uJrat nentokesore jane sqaruar ne sksionin gjeologjik nga siperfaqe e tokes, ndersa projekti do te ndikojte ne germim te gropes per bazamente deri ne 2-5 m nen nivelin e siperfaqes se tokes per vendosjen e veprave te HEC.

Masat parandaluese

Gjate procesit te ndertimit nuk do te kemi rezik te ndotjes se ujrave nentokesore si rezultat i derdhjes se vajrave lubrifikant.

Impakti ne ujrat siperfaqesore

Impakti nga ndertimi

Cdo nenproces ndikimi ne mjedis do te jete i moderuar per vete faktin se zonat ku do te ndertohen keto vepra, siperfaqet uJore ndodhen prane objekte jane te vendosura ne lartesi dhe jo pergjate shtratit te tij pasi uji do te shfrytezohet duke e devijuar me kanale derivacioni. Depozitimi i mbetjeve te cilat do te gjenerohen nga procesi i ndertimit do te jene ne distanca te largeta nga ky burim uJOR i levizshem.

Masat parandaluese

Gjate procesit te ndertimit nuk do te kemi rezik te ndotjes se ujrave si rezultat i derdhjes se vajrave lubrifikant.



f. Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimeve negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.

Prekshmeria klimaterike e prodhimit hidroenergjitik

Prodhimi hidroelektrik mund te jete shume me i ndjeshem ndaj ndryshimeve ne prurjet e lumenjve ssesa llojet e tjera te sistemeve ujore, si edhe eshte i prekshem nga konkurenca me perdoruesit e tjere te ujit. Psh te drejtat e ujit per ujitje dhe sitemet e ujesjelles-kanalizimeve kane epersi mbi te drejtat per prodhimin hidroelektrik. Ndryshimi i klimes do te coje ne rritje te kerkeses per uje te pijshem dhe do te kete nevojte per me shume uje per ujitje ne bujqesi.

Sipas studimeve nje pakesim prej 20% i prurjeve ujore natyrore parashikohet te shkaktoje nje pakesim te prodhimit energjitik prej 60% ndersa nje rritje prej 20% parashikohet te sjelle nje rritje te prodhimit te energjise prej 40%.

Ndryshimet ne flukset maksimale lumore kane efekte te drejtperdrejta ne projektimin e hidrocentraleve te vegjel. Tani per tani efektet e ndryshimit te klimes nuk merren ne konsiderate ne projektimin dhe planifikimin e hidrocentraleve.

Prekshmeria lidhur me sigurine e energjise dhe sherbimin

Deri tani ekziston nje mungese drejtpeshimi midis ofertes dhe kerkeses per energji ne Shqiperi. Kerkohet te merren ne konsiderate efektet e ndryshimit te klimes ne cekuilibrin midis ofertes dhe kerkeses. Humbje ne sistem qe jane mbi standartin. Rritje e shkarkimit te ujit ne hidrocentrale per shkak te rritjes se rreshjeve ekstreme shkakton nje humbje te drejteperdrejte te prodhimit te energjise kosto dhe humbje te drejteperdrejta financiare.

Ngjarjet klimaterike ekstreme shkaktojne qe sistemi energjitik te mos jete ne nje situate normale shfrytzezimi dhe shkaktojne humbje me te larta ne transmetim.

Njeri prej problemeve me te rendesishme te identifikuar eshte keqadministrimi i tanishem i burimeve ujore ne Shqiperi nga komuniteti. Ndryshimi i klimes mund te coje ne rritje te rrezikut te konflikteve midis perdoruesve te ujit per shkak te rritjes se kerkeses dhe paksimit te burimeve ujore te gateshme.

g. Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te sipërfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.

Investitori, me aktivitet ne fushen e shfrytzezimit te energjise hidro ka investuar dhe disponon mjetet e nevojshme per shfrytzezim te HEC-it.

Organizimi

HEC do te jete nene administrimin e shoqerise investitore dhe do te kete nje administrator, drejtues teknik, specialiste, punetore mirembajtje te linjave te marrjes se ujit, shofere dhe roje te ketyre objekteve etje. Ne hidrocentral do te punohet me tre turne, ndersa muajt e veres do te kete reduktim te prodhimit te energjise per mungese te prurjeve dhe per realizimin e remonteve.

Masat e sigurimit teknik ne pune jane shume te rendesishme dhe do te zbatohen me perpikemerine nga shoqeria.